

06/ZDP/VE/2024
Datë: 13 mars 2024

Në mbështetje të nenit 14.1, 15.1 (f), 21.2 dhe 81 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, nenit 24 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7, dt. 1 mars 2019), nenit 50 të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20, dt. 21 qershor 2016), Rregullores (AAC) nr. 03/2015 mbi tarifatat e aeroporteve,

Duke vepruar në bazë të kërkesës së Departamentit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik të Aviacionit në AAC-së për ndryshim të Vendimit nr. 03/ZDP/VE/2022, për shkak të gabimit të lëshuar teknik në aprovimin e programit të nxitës 2022-2024,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

V E N D I M

1. Korrigjohet pika 3) e Vendimit nr. 03/ZDP/VE/2022, dt. 09.03.2022, për aprovimin e Programit nxitës 2022-2024 për ANP "Adem Jashari", si në vijim:

Fjalja- *"Programi është efektiv për periudhën 27 mars 2022 - 30 mars 2024."*

Zëvendësohet me fjalinë- *"Programi është efektiv për periudhën 27 mars 2022 - 29 mars 2025."*

2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M


Më datën 07 mars 2024, Drejtori i Përgjithshëm të AAC-së, ka pranuar kërkesën nga Departamentit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik të Aviacionit në AAC-së për ndryshim të Vendimit nr. 03/ZDP/VE/2022, për shkak të gabimit teknik të lëshuar gjatë aprovimit të programit të nxitës 2022-2024 për Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". Gjatë përpilimit të Vendimit në fjalë ishte bërë gabim në periudhën vlefshmërisë së këtij programi nxitës. Në nenin 5 të Programit Nxitës është e specifikuar që Programi është valid prej sezonit të verës 2022 deri në fund të sezonit dimëror 2024, gjë që i bie që programi është valid deri në fund të përfundimit të këtij sezoni dimëror, pra në fund të muajit mars 2025.

Në Vendimin me nr. 03/ZDP/VE/2022, i dt. 09.03.2022 për aprovim të programit nxitës 2022-2024 ishte përvjedhur një gabim teknik në periudhën e vlefshmërisë së programit ku në pikën 3) të vendimit thuhet "Programi është efektiv për periudhën 27 mars 2022 - 30 mars 2024" në vend të "Programi është efektiv për periudhën 27 mars 2022 - 29 mars 2025".

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në pajtim me nenin 14.1, 15.1 (f), 21.2 dhe 81 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, ndryshuar me Ligjin nr.

08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, nenin 24 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenin 50 Ligji Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative, Rregulloren (AAC) nr. 03/2015 mbi tarifat e aeroporteve dhe duke vepruar në përputhje me kërkesën e Departamentit të BNRREA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim mbi mjetin juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të ngrit konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimiit.


Alban Ramabaja
Ud. Drejtor i Përgjithshëm



Iu dërgohet:

- ANP "Adem Jashari", operatorit LKIA;
- Departamentit PPP, MFPT;
- Departamentit të Aviacionit Civil, MMPHI; dhe
- Arkivit të AAC-së.